

**PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS: “Supervizim per ndertimin e disa godinave te reja per Spitalin Psikiatrik Elbasan”**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):**

- Mbikëqyrja e punës së ndërtimit 71247000-1

**VLERA E FONDIT LIMIT: 3.819.304,69** (tre milion e teteqind e nentembedhete mije e treqind e kater presje gjashtedhete e nente) **lekë pa tvsh**, vënë në dispozicion **nga Buxheti i Shtetit, me objekt: “Supervizim per ndertimin e disa godinave te reja per Spitalin Psikiatrik Elbasan”, per 3(tre) vite, 2024,2025 dhe 2026, me ndarje si me poshte:**

- Për vitin 2024, është 783.333 (shtateqind e tetedhete e tre mije e treqind e tridhete e tre) lekë pa TVSH;
- Për vitin 2025, është 1.750.000 (nje milion e shtateqind e pesedhete mije) lekë pa TVSH;
- Për vitin 2026, është 1.285.972 (nje milion e dyqind e tetedhete e pese mije e nenteqind e shtatedhete e dy) lekë pa TVSH;

Në bazë të Nenit 21, pika 2, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”; Nenit 2, pika 2/c si dhe Nenit 78, pika 2, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Autoriteti Kontraktor, Spitali Psikiatrik ”Sadik Dinçi” Elbasan, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Për këtë i kërkohet supervizionit të punimeve të kësaj kontrate të kryejë mbikëqyrjen e këtij objekti me fondin limit të mbikëqyrjes së llogaritur sipas VKM-së nr.354/2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”.

---

**I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

**1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:**

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 10.

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

## **2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

### **2.1. Përshatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):**

- sipas Shtojcës 10

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

### **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare **2021, 2022, 2023**, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se **100%** të vlerës së fondit limit të lotit që oferton.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

---

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Nenin 43, pika 1 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare”.

2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare **2021, 2022, 2023**, të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41 shkronja c) të Ligjit nr. 1009/2009 “Për auditimin ligjor,

*organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, *Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare". Referuar në Nenin 29 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat tatimore" "Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në Udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në Udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji".*

### **2.3 Kapaciteti teknik:**

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se **40%** të vlerës së fondit të limitit të lotit që oferton.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 3 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e

mëparshme të ngjashme të jenë ne vlerën jo më pak se **40%** të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

*Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garantojnë autoritetin, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së shërbimeve të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të Nenit 88, pika 1 e VKM 285/2021, parashikon se: “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të Nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve”.*

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencë të vlefshme **për mbikëqyrje punimesh zbatimi në ndërtim** të lëshuar nga **Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë**, sipas përcaktimit në VKM Nr. 759, datë 12.11.2014 “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e koaludimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, ndryshuar me VKM-në Nr. 943, datë 28.12.2016”.

Licenca profesionale e operatorit ekonomik lidhur me shërbimin e mbikëqyrjes së punimeve të zbatimit në ndërtim duhet të përmbajë kategoritë e mëposhtme:

<b>Kategori</b>	<b>Emërtimi i kategorisë</b>
NP-1.	Punime gjurmimi në tokë
NP-2.	Ndërtime civile dhe industriale
NS-8 b.	Struktura metalike
NS-12.	Impiante teknologjik, termike dhe të kondicionimit.
NS-13.	Impiante dhe linja telefonie dhe telekomunikacioni
NS-14.	Impiante të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj.
NS-18.	Punime topogjeodezike
NS-20	Punime Gjeologjike

*Shoqëritë e huaja duhet të bëjnë ekuivalentimin e licencave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Republika e Shqipërisë.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, si dhe vendimin nr.759, datë 12.11.2014 të Këshillit të Ministrave, “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve

*juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e koaludimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, ndryshuar me VKM-në nr. 943 datë 28.12.2016”.*

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente kompetente.

*Meqënëse kemi të bëjmë me Mbikëqyrjen punimesh zbatim në ndërtim argumentojmë se:*

*Kategoritë e mësipërme janë përcaktuar në përputhje me zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventivat e punimeve të zbatimit për objektin në fjale. Gjithashtu, këto kategori licence bazohen edhe në projektin / Specifikimet teknike të punimeve të zbatimit për këtë objekt.*

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e shërbimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **personelin kryesor Drejtues Teknik** (drejtues teknik i shoqërisë për mbikëqyrje e kolaudim I perfshire ne licencen e shoqerise, dhe i pajisur me licencë profesionale individuale në fushat respective si dhe te figuroje ne listpagesen e shoqerise për të paktën tre muajt e fundit), si më poshtë:

Nr.	TITULLI
•	1 ( nje) Inxhinier Ndërtimi Strukturist/Civile Industriale
•	1 ( nje) Inxhinier Elektrik
•	1 ( nje) Inxhinier Mekanik
•	1 ( nje) Inxhinier Elektronik/Elektroteknik
•	1 ( nje) Inxhinier Gjeodet/Topograf/Markshajder
•	1 ( nje) Arkitekt
•	1 ( nje) Inxhinier Hidroteknik
•	1 ( nje) Inxhinier Gjeolog

*\*\* Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës Nr 10. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”.*

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

- Kontratë pune të vlefshme
- Licencë profesionale individuale për mbikëqyrje e kolaudim,
- Diplomë

- Librezë pune
- CV

Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

*Argumentojme se njësia e prokurimit për zgjedhjen e stafit të mbikëqyrjes është bazuar në punimet respektive të përfshira në projekt preventivat e punimeve të zbatimit për objektin në  **fjale.**, gjithashtu i është referuar dhe Termave të Referencës.*

2.3.4 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e shërbimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin Staf Mbeshtetes i pajisur me licencë profesionale individuale në fushat respective, si dhe te figuroje ne listpagesen e shoqerise për të paktën tre muajt e fundit), si më poshtë:

1 ( nje) Inxhinier Ndërtimi Strukturist/Civile Industriale

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

- Kontratë pune të vlefshme
- Licencë profesionale individuale për mbikëqyrje e kolaudim,
- Diplomë
- Librezë pune
- CV

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

*Argumentojme se njësia e prokurimit për zgjedhjen e stafit të mbikëqyrjes është bazuar në punimet respektive të përfshira në projekt preventivat e punimeve të zbatimit për objektin në  **fjale.**, gjithashtu i është referuar dhe Termave të Referencës.*

2.3.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kësaj kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej  **minimalisht 15 (pesembedhete) persona.** Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve për të paktën tre muajt e fundit, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

\*\*\* Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës Nr 10. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”.

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet Shoqërore ose Administrata Tatimore sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj, për të paktën tre muajt e fundit
- Listëpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për të paktën tre muajt e fundit

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Numri i përcaktuar i punonjësve është përllogaritur bazuar në personelin kryesor që duhet të disponojë Operatori Ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e shërbimeve objekt kontrate.

Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështrirje **per 3 muajt e fundit** tregon besueshmëri për autoritetin.

Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë çdo dëshmi me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve dhe përvojën e tyre, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, përpiket të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës, po ashtu është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve.

2.3.6 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e shërbimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin , si dhe te figuroje ne listpagesen e shoqerise për të paktën tre muajt e fundit), si më poshtë:

a) Operatori/ët ekonomik duhet të ketë në stafin 1 (një) specialist Ekspert Zjarrfikës në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin, në përputhje me klauzolat Ligjit Nr. 152/2015 “Për

*shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin”, Neni 49, pika 4, shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplomë/certifikatë, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë minimumi për 3 muajt e fundit, të deklaruar nga data e hapjes së ofertave. ose eksperti zjarrëfikës mund të sigurohet nga operatori ekonomik edhe me anë të marrëdhënies kontraktore për ekzekutimin e kontratës objekt prokurimi. Në rastin kur eksperti zjarrëfikës mund të sigurohet nga operatori ekonomik edhe me anë të marrëdhënies kontraktore do të paraqitet kontrata për këtë shërbim, certifikata përkatëse, si dhe fatura e këtij shërbimi. (Në rastin e Bashkimit të Operatorëve ekonomikë, Grupimi duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) specialist Ekspert Zjarrfikës në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin).*

b) 1 (një) punonjës me certifikatë “*Ekspert për ndikimin e vlerësimit në mjedis*” (VNM) të pajisur me certifikatë të lëshuar nga Ministria e Mjedisit, shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplomë/certifikatë, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë minimumi për 3 muajt e fundit, të deklaruar nga data e hapjes së ofertave. (Në rastin e Bashkimit të Operatorëve ekonomikë, Grupimi duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 Ekspert për ndikimin e vlerësimit në mjedis” (VNM))”

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

*Argumentojme se njësia e prokurimit për zgjedhjen e stafit të mbikëqyrjes është bazuar në punimet respektive të përfshira në projekt preventivat e punimeve të zbatimit për objektin në **fjale.**, gjithashtu i është referuar dhe Termave të Referencës*

## **2.4. Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim**

2.4.1 Operatori/et ekonomik/ë duhet të paraqesin certifikatat e cilësisë së punimeve, të vlefshme (ose ekuivalente) për objektin që prokurohet, si më poshtë:

- ISO 9001:2015 ( të vlefshme, ose ekuivalente), e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Certifikatën
- ISO 14001:2015 ( të vlefshme, ose ekuivalente), e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Certifikatën
- ISO 45001:2018( të vlefshme, ose ekuivalente), e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Certifikatën



- EN-ISO 3834-2:2021( të vlefshme, ose ekuivalente), e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Certifikatën
- ISO 50001-2018( të vlefshme, ose ekuivalente), e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Certifikatën

Të gjitha certifikatat e mësipërme duhet të jenë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

**Argumentimi:** *Kërkesat e mësipërme janë vendosur bazuar në Nenin 79, pika 1 të Ligjit nr. 162/2020, “Për Prokurimin Publik”, sipas të cilit: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe në zbatim të Nenit 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku përcaktohet se:*

*“Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.*

*Certifikatat e cilesise jane bazuar ne perputhje me objektin e zbatimit qe do te mbikëqyret dhe jane ne perputhje me natyren dhe objektin e kontrates qe prokurohet.*

## **II. Argumentimi i specifikimeve teknike**

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

*Specifikimet teknike të përfshira në termat e referencës janë hartuar në mbështetje të dispozitave të Ligjit Nr.8402 datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, Udhëzimit të Këshillit të Ministrave nr. 3 date 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe*

*kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Udhëzimit nr.2 datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve te ndërtimit”.*